



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 549, datë 29.7.2022

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.260, DATË 5.5.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PARAQITJES,
FORMËS DHE NDËRTIMIT TË GRADAVE TË PUNONJËSVE
TË POLICISË SË BURGJEVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 43, të ligjit nr.80/2020, "Për Policinë e Burgjeve", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shtojca nr.1 bashkëlidhur vendimit nr.260, datë 5.5.2021, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I DREJTËSISË

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 549, datë 29.7.2022

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.260, DATË 5.5.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PARAQITJES,
FORMËS DHE NDËRTIMIT TË GRADAVE TË PUNONJËSVE
TË POLICISË SË BURGJEVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 43, të ligjit nr.80/2020, "Për Policinë e Burgjeve", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shtojca nr.1 bashkëlidhur vendimit nr.260, datë 5.5.2021, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA


MINISTRI I DREJTËSISË

ULSI MANJA

KREU I GRADAT

1. Gradat për punonjësin e rolit bazë përbëhen nga grada “Nëninspektor”, “Inspektor” dhe “Kryeinspektor”, si vijon:

a) grada “Nëninspektor”:




- i. është gradë fillestare e nivelit të rolit bazë;
- ii. paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin e saj. Në gjerësinë e gradës është vendosur një shirit ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari);

b) grada “Inspektor”:



- i. është gradë e dytë e nivelit të rolit bazë;
- ii. paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin. Në gjerësinë e gradës janë vendosur dy shirita të verdhë (ngjyrë ari) me përmasa të ndryshme;

c) grada “Kryeinspektor”:



- i. është gradë e tretë e nivelit të rolit bazë;
- ii. paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin e saj. Në gjerësinë e gradës janë vendosur tri shirita të verdhë (ngjyrë ari), me përmasa të barabarta;

2. Gradat për punonjësin e rolit të mesëm përbëhen nga grada nënkomisar, komisar dhe kryekomisar, si vijon:

a) grada “Nënkomisar”:



- i. është gradë e parë e nivelit të rolit të mesëm;

ii. paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin e saj. Në gjerësinë e gradës është vendosur një shirit i verdhë (ngjyrë ari) me përmasë të gjerë, një kurorë dafine dhe një yll i madh me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari);

b) grada “Komisar”:



i. është gradë e dytë e nivelit të rolit të mesëm;

ii. paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin e saj. Në gjerësinë e gradës janë vendosur dy shirita të verdhë (ngjyrë ari) me përmasë të gjerë, një kurorë dafine dhe dy yje të mëdhenj me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari);

c) grada “Kryekomisar”:



i. është gradë e tretë e nivelit të rolit të mesëm;

ii. paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët, me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin e saj. Në gjerësinë e gradës janë vendosur tre shirita të verdhë (ngjyrë ari) me përmasë të gjerë, një kurorë dafine dhe tre yje të mëdhenj me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari);

3. Gradat për punonjësin e rolit të lartë përbëhen nga grada drejtues dhe drejtues i lartë, si vijon:

a) grada “Drejtues”:



i. është gradë e parë e nivelit të rolit të lartë;

ii. paraqitja e kësaj grade do të jetë e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin e saj. Në gjerësinë e gradës janë vendosur tri shirita të verdhë (ngjyrë ari) me përmasë të gjerë, një kurorë dafine, një beden kalaje dhe një yll i madh me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari);

b) grada “Drejtues i lartë”:



i. është gradë e Drejtorit të Policisë së Burgjeve;

ii. paraqitja e kësaj grade është e përbërë nga një fushë me ngjyrë blu të errët me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin e saj. Në gjerësinë e gradës janë vendosur tri shirita të verdhë (ngjyrë ari) me përmasë të gjerë, një kurorë dafine, një beden kalaje dhe dy yje të mëdhenj me pesë cepa, të gjitha këto me ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari);

KREU II


GRADAT E VOGLA TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE

Gradat e vogla të shërbimit të Policisë së Burgjeve vendosen lart në gjoksin e majtë të çdo artikulli të uniformës.

1. Gradat e vogla të shërbimit për rolin bazë:


a) Nëninspektor:

i. forma e përgjithshme e gradës përbëhet, në gjerësinë e gradës është vendosur një shirit ngjyrë të verdhë (ngjyrë ari)




b) Inspektor:

iii.i. forma e përgjithshme e gradës përbëhet nga një fushë me ngjyrë blu të errët, me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin. Në gjerësinë e gradës janë vendosur dy shirita të verdhë (ngjyrë ari) me përmasa të ndryshme;



c) Kryeinspektor:


iv.i. forma e përgjithshme e gradës përbëhet nga një fushë me ngjyrë blu të errët, me kontur ngjyrë të verdhë në të gjithë perimetrin. Në gjerësinë e gradës janë vendosur tri shirita të verdhë (ngjyrë ari) me përmasa të ndryshme;



2. Gradat e vogla për punonjësit e rolit të mesëm:


a) Nënkomisar:

i. forma e përgjithshme e gradës përbëhet nga një shirit dhe një yll me pesë cepa të vendosur sipër kurorës;




b) Komisar:

i. forma e përgjithshme e gradës përbëhet nga dy vija dhe dy yje me pesë cepa të vendosur sipër kurorës;



c) Kryekomisar:


i. forma e përgjithshme e gradës përbëhet nga tri vija dhe tre yje me pesë cepa të vendosur sipër kurorës.



3. Gradat e vogla të punonjësve të rolit të lartë:


a) Drejtues:

i. forma e përgjithshme e gradës përbëhet nga një beden kalaje, tri vija dhe dy yje me pesë cepa;



b) Drejtues i lartë:

i. forma e përgjithshme e gradës përbëhet nga një beden kalaje, tri vija dhe dy yje me pesë cepa.



NR.PROT.4388/1
DATË 2.8.2022

MINISTRISË SË DREJTËSISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

